

# Lista e Institucioneve Publike, 2021

**Tiranë, më 13 Shtator 2022:** INSTAT, ofron për përdoruesin listën e institucioneve publike, pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme si dhe ndërmarrjet Financiare dhe Jo-financiare që janë në pronësi të entiteteve publike për vitin 2021.

[Lista e institucioneve publike, pjesë e sektorit publik](#) (link)

Njësitë shpenzuese buxhetore të Sektorit Publik përbëhen nga: nën-sektori i Qeverisë Qendrore (S.1311) me 841 njësi shpenzuese buxhetore, nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 194 njësi shpenzuese buxhetore dhe nën-sektori Fondet e Sigurimeve (S.1314) me 2 njësi shpenzuese.

Ndryshimi i numrit të njësive shpenzuese buxhetore ndër vite vjen si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të Qeverisë, riklasifikimeve, si dhe njësive të reja apo të mbyllura.

**Tab. 1 Sektori Publik në Shqipëri, Viti 2021**

Klasifikimi sipas nën-sektorëve		Viti 2021
Qeveria Qendrore	S.1311	900
	<i>Buxhetore<sup>1</sup></i>	841
	<i>Extra-Buxhetore</i>	59
Qeveria Federale <sup>2</sup>	S.1312	-
Qeveria Lokale	S.1313	304
	<i>Buxhetore</i>	194
	<i>Extra-Buxhetore</i>	110
Fondet e Sigurimeve	S.1314	2
Ndërmarrjet Publike Jo-financiare	S.11001	27
Ndërmarrjet Publike Financiare	S.12	2
Banka Qendrore	S.121	1
<b>Totali i Njësisve Shpenzuese</b>		<b>1.236</b>

Njësitë extra-buxhetore të Sektorit Publik përbëhen nga nën-sektori i Qeverisë Qendrore (S.1311) me 59 njësi shpenzuese dhe nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 110 njësi shpenzuese.

Përveç institucioneve buxhetore dhe extra-buxhetore, sektori publik, përfshin edhe nën-sektorin e ndërmarrjeve Publike Jo-financiare (S.11001) me 27 njësi, nën-sektorin e ndërmarrjeve Publike Financiare (S.12) me 2 njësi dhe nën-sektorin e Bankës Qendrore (S.121) me 1 njësi.

<sup>1</sup> Numri i Njësisve Shpenzuese buxhetore përbëhet nga njësitë aktive shpenzuese që raportohen në sistemin e thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2021.

<sup>2</sup> S.1312 - Qeveria Federale, ky nën-sektor nuk aplikohet në Shqipëri.

**Për publikim 13/09/2022**